



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M
Nr.1728, datë 20.12.2011

Për

“Miratimin e propozimit për Ministrin të kufizimeve të mundshme për dhënien e frekuencave në brezat 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz që ofrojnë shërbime me brez të gjerë (UMTS) dhe procedurat përkatëse të tenderimit për dhënien e tyre”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 20.12.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e propozimit për Ministrin të kufizimeve të mundshme për dhënien e frekuencave në brezat 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz që ofrojnë shërbime me brez të gjerë (UMTS) dhe procedurat përkatëse të tenderimit për dhënien e tyre”

BAZA LIGJORE:

1. Pika 10 e nenit 5, pika 5 e nenit 68, neni 69 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*)
2. Pika 16.4 VKM Nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”

i ndryshuar me VKM Nr.501 date 09.06.2010 “Për disa ndryshime në vendimin Nr.1252 datë 10.09.2008 të Këshillit të Ministrave”;

3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (***Rregullorja e Brendshme***), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si me poshte:

- Propozimi i hartuar nga grupi i punes sëbashku me relacionin përkatës;
- Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Dokumentacioni për **“Miratimin e propozimit për Ministrin te kufizimeve të mundshme për dhënien e frekuencave në brezat 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz që ofrojnë shërbime me brez të gjerë (UMTS) dhe procedurat përkatëse të tenderimit për dhënien e tyre”** është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

- Propozimet e AKEP për miratim nga Ministri te **kufizimeve të mundshme për dhënien e frekuencave në brezat 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz që ofrojnë shërbime me brez të gjerë (UMTS) dhe procedurat përkatëse të tenderimit për dhënien e tyre** bazuar në Pika 16.4 VKM Nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave” i ndryshuar me VKM Nr.501 datë 09.06.2010 “Për disa ndryshime në vendimin Nr.1252 datë 10.09.2008 të Këshillit të Ministrave”, si dhe
- Pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

V E N D O S:

1. Të miratojë **propozimin për Ministrin të kufizimeve të mundshme për dhënien e frekuencave në brezat 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz që ofrojnë shërbime me brez të gjerë (UMTS) dhe procedurat përkatëse të tenderimit për dhënien e tyre**, sipas dokumentit bashkëlidhur.

2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Alketa MUKAVELATI** _____
3. **Benon PALOKA** _____
4. **Zamira NURÇE** _____

PROPOZIM

për

“Miratimin e kufizimeve të mundshme për dhënien e frekuencave në brezat 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz dhe procedurat përkatëse të tenderimit për dhënien e tyre”

Në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 776, Prot., datë 05.12.2011 “ Për ngritjen e grupit të punës mbi përgatitjen e propozimit për vazhdimin e procedurës për dhënien e drejtës së përdorimit të frekuencave në brezin 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz dhe procedurat përkatëse të tenderimit për dhënien e tyre ”,

Bazuar në:

pikën 10 të nenit 5, pikën 5 të nenit 68, nenin 69 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*) dhe pikës 16.4 - Kreu III, të VKM Nr. 1252, datë 10. 09. 2008 “ Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave” (*VKM Nr. 1252*),

parashtrijmë sa më poshtë vijon:

1. Sipas vlerësimit të kryer nga AKEP dhe rezultateve të procesit të këshillimit publik të kryer me palët e interesuara për këtë qëllim, në gjysmën e parë të vitit 2010, disponibiliteti i frekuencave në brezat **1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz që ofrojnë shërbime me brez të gjerë (UMTS)**, ishte për dhënien e 4(katër) të drejtave për përdorimin e tyre.

2. Me dhënien e dy Autorizimeve të mëparshëm Individual për përdorimin e frekuencave të brezit 1920.3-1935.3/2110.3-2125.3 MHz dhe 1900.0-1905.0 MHz sipërmarrësit “Vodafone Albania” Sh.a., dhe brezit 1935,3-1950,/ 2125,3 – 2140,1 MHz dhe 1905-1910 MHz sipërmarrësit Albanian Mobile Communications Sh.a. nëpërmjet zbatimit të tenderit publik miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP-it, disponibiliteti i frekuencave në këto breza është për 2 (dy) të drejta përdorimi:

A	2x15 MHz spektër i çiftuar (1950-1965 - çiftuar me 2140-2155) dhe, 5 MHz spektër i paçiftuar (1910-1915)
B	2x15 MHz spektër i çiftuar (1965-1980 - çiftuar me 2155-2170) dhe, 5 MHz spektër i paçiftuar (1915-1920)

3. Palët e interesuara në treg (operatorët që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike – telefoni e lëvizshme), kanë paraqitur pranë AKEP-it kërkesa për pajisjen me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave në brezat 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz që ofrojnë shërbime me brez të gjerë (UMTS).

Nisur nga sa më sipër, në vijim të procesit të nisur për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave në brezat **1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz**, bazuar në:

- Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP-it Nr. 1367, datë 25.08.2010 “Për miratimin e publikimit të përfundimeve të këshillimit publik **“Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz që ofrojnë shërbime me brez të gjerë (UMTS)”** dhe njoftimin për kufizimin e numrit të të drejtave të përdorimit të frekuencave”” dhe akteve të tjera të AKEP për këtë qëllim;
- Procedurën e zbatuar për **“Dhënien e 2 (dy) të drejtave të përdorimi në brezat e frekuencave 1920-1935 MHz çiftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spektër i paçiftuar, si dhe 1935-1950 MHz çiftuar me 2125– 2140 MHz dhe 1905-1910 MHz spektër i paçiftuar që ofrojnë shërbime me brez të gjerë”**;
- Përcaktimeve ligjore për këtë qëllim të parashikuara në ligjin nr. 9918 dhe VKM Nr. 1252 (i ndryshuar);

P R O P O Z O J M Ë:

1. Vijimin e procedurës së tenderit publik për dhënien e të drejtës së përdorimit për frekuencat **2x15 MHz spektër i çiftuar 1950-1965 - 2140-2155 MHz dhe, 5 MHz spektër i paçiftuar 1910-1915 MHz**;
2. Procedura për dhënien e të drejtës së përdorimit të këtyre frekuencave të jetë **“procedurë e hapur”**, në përputhje me përcaktimet e parashikuara në VKM Nr. 1252 (i ndryshuar);
3. Numri i të drejtave që mendohet të jepet për përdorimin e frekuencave në brezat e frekuencave që ofrojnë shërbime me brez të gjerë (UMTS), propozohet të jetë 1(një), sipas germës A të tabelës së vendosur në pikën 2 të parashtrimeve të këtij propozimi;
4. Çmimi minimal i një autorizimi, duke patur parasysh formulën e aplikuar për dhënien e autorizimit të parë individual, çmimin e dhënë nga sipërmarrësit pjesëmarrës në tenderin publik të parë dhe të dytë, si dhe rrethanat aktuale të tregut, të jetë 12.500.000 (dymbëdhjetë milionepesëqindmijë) Euro/Autorizim Individual.
5. Kriteret e vlerësimit të ofertave të jenë të njëjta me ato të aplikuara në tenderin e parë e të dytë të zhvilluar për këtë qëllim:

a- Çmimi i ofertës

b- Koha e mbulimit me shërbim

I. Pikët për seicilin kriter do të jenë:

a- 90 (nëntëdhjetë) pikë për çmimin e ofertës

Do të vlerësohet me 90 pikë oferta e vlefshme me çmimin më të lartë. Të gjithë ofertat e tjera do të vlerësohen sipas formulës së mëposhtme :

$$Pox = 90 \times \frac{\text{Çox}}{\text{Çomax}}$$

Ku:

Pox → [Pikët e një oferte të dhënë (x) në varësi të çmimit të ofertës]

Çox → [Çmimi i ofertës së dhënë (x)]

Çomax → [Çmimi maksimal i ofertave]

b- Do te vleresohet me 10 pike cdo ofertues i cili ne oferten e tij do te paraqese plan mbulimi me sherbim ne shkalle gjeografike ne perputhje me tabelen e meposhtme dhe 0 (zero) pikë për mosplotësim të këtij kriteri:

Periudha nga koha e marrjes se Autorizimit Individual	Shenime
Deri ne fund te 6 mujorit te pare	Jo me pak se 35% te territorit
Deri ne fund 12 muajve	Jo me pak se 65% te territorit
Deri ne fund te 18 muajve	Jo me pak se 85% te territorit

GRUPI PUNËS:

Shefqet Meda _____

Frederik Kote _____

Vasil Mitezi _____